

TITULLI

Autori: (emer, mbiemer)

Perktheu: (emer, mbiemer)

*Udhezim: Teksti i vepres duhet te jete me fontin
Verdana 12pike, me marxhina lart e poshte faqjes
2.54cm dhe dhe marxhina anash 5.08cm*

Personazhet

- Personazhi A
- Personazhi A
- Personazhi A
- Personazhi A
- Personazhi A

Vendndodhja:

Kjo eshte nje drame imagjinate. Mund te adaptohet per skene te cdo forme dhe permase. Objektivi i produksionit fizik duhet te jete ruajtja e kesaj fryme imagjinare—nje forme realizmi magjik. Regjizoret dhe krijuesit duhet te lejojne aspektin imagjativ te krijimtarise se tyre qe te dominoje inskenimin e drames.

AKTI I

(Tek porta Rashomon.

Muzika e hapjes se drames shkrihet me zhurmen e shiut, ndersa dritat ndricojne nje qoshe te kesaj strukture te rrenuar dhe te braktisur, qe dikur ka qene hyrja e lavdishme e qytetit Kioto. Tani shfaqet gri dhe e shkaterruar nen rrebeshin e shiut dhe duket sikur eshte teper larg pjeses se banuar te qytetit.

Ne nje strehe te improvizuar nen porten, nje PRIFT budist rri ulur mbi dyshemene e gurit prane nje zjarri te vogel e te mekur. Prane tij eshte nje boce e vogel qe permban te gjitha placken qe prifti ka te tijen ne bote. Shkopi i tij eshte mbeshtetur tek kolona e portes. Ai duket me i lodhur dhe i plakur se mosha e tij – tek te 30tat – fytyra e tij e shfaq dorezimin ndaj humbjes. I veshur me nje kimono te erret ai I ka hedhur syte tutje horizontit, I kredhur ne mendime.

Pas disa castesh shfaqet DRUVARI, i cili vjen me vrap drejt portes. Ai eshte i veshur me nje rrobe te ashper artizanale dhe ka te lidhur ne brez me litar nje sopate/sqepar te vogel. Ai nxiton per tek shkallet e portes, shikon rrotull dhe ndalon kur shikon PRIFTIN. Ai perulet perpara tij me respekt.)

DRUVARI: (I merret fryma). Me falni, at i shenjte, kam ardhur me vrap qe nga qyteti. (tregon me veprim se nga erdhi). Nuk m'u besua kur me thane ne Pazar "Prifti na braktisi". "e keni gabim", ju thashte " ai do te kthehet me siguri". (shikon plackat e mbledhura te prifit). Pra, qenka e vertete? Ju po largoheni? (PRIFTI tund koken ne shenje pohimi pastaj e mbulon fytyren me duar. DRUVARI mundohet te flase por nuk gjen dot fjalet. Ai fshin

TITULLI I VEPRES

shiun nga fytyra dhe papritur bie serish ne gjunje perpara PRIFTIT). Me falni, por duhet te flas. E di qe ato gjera qe pame e degjuam dje ne stacionin e policise ishte si nje makth i lig qe te ngjeth mishin. Nje gjeme e pakuptueshme. Por qe te braktisni tempullin – edhe kjo eshte e pakuptueshme.

PRIFTI: e cfare ka me kuptim ne kete vend?

DRUVARI: une jam nje druvar i thjeshte. E vetmja gje qe di eshte te pres dru derisa te me mpien muskujt e duart te me regjen nga kallot. (*ai ekzaminon duart e tij*)

PRIFTI: (*nen ze sikur flet me vete*) Termete –

DRUVARI: si thate?

PRIFTI: zjarr, murtaje, zi buke –

DRUVARI: keto jane gjera te natyrshme, si shiu dhe dielli. Njeriu nuk duhet te sfilitet duke i kerkuar kuptimin.

PRIFTI: megjithate, dhunen e termetit e kuptoj. (*ngrihet ne kembe*) Por barbarine e njerezve kunder njeri-tjetrit, kunder vetes... (*i hedh syte nga rruga qe te largon nga qyteti*)

DRUVARI: kjo eshte streha e fundit ne kete rruge. Nuk keni ku te gjeni vend me tutje. Me besoni, e njoh mire. (*hedh syte rrotull*). E di qe kjo rrenoje eshte e frikshme, por eshte me mire te prisni ketu deri sa te pushoje stuhia.

PRIFTI; (*kthehet dhe shikon strehen, dora prek kolonen e rrenuar*). Porta e lavdishme Rashomon (*nje ashkel e shpon ne dore*). Vazhdon te rrenohet – si njerezit e ketij vendi.

(*nga drejtimi i qytetit degjohen kembanat e tempullit qe njoftojne oren*)

TITULLI I VEPRES